



ORGANIZATA PËR SIGURI DHE BASHKËPUNIM NË EVROPË



MISIONI I OSBE-SË NË KOSOVË

Misioni OSBE-së ndihmon përfshirjen e të rinjëve në proceset vendimarrëse duke i'u ofruar trajnime dhe udhëzime për përgjegjësitë e qeverisë dhe mënyrat e lobimit.

Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë punon për stabilitet, mirëqenie dhe demokraci në 56 shtete. Përmes vlerave të përbashkëta, dialogut politik dhe punës praktike organizata mëton të sjellë ndryshime të qëndrueshme.

Misioni i OSBE-së në Kosovë ka marrë përsipër ndërtimin e institucioneve dhe promovimin e të drejtave të njeriut, dhe këtë e arrinë me një presence të gjërë në nivel komunal.



**PËR INFORMATA
KONTAKTONI:**

**Selinë e Misionit të OSBE-së
Prishtinë, Kosovë - UNMIK**

Tel: + 381 38 500 162, 240 100

Fax: + 381 38 240 711

www.osce.org/kosovo

press.omik@osce.org

HYRJE

Misioni i OSBE-së është njëri ndër akterët kryesorë ndërkombëtarë i përfshirë në proceset demokratike si dhe në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut në Kosovë.

Detyrat kryesore janë:

- Të krijojë një ekzekutiv të aftë dhe efikas, organe ligjvënëse dhe institucione gjyqësore brenda Institucioneve të Përkohshme Vetëqeverisëse të Kosovës (IPVQ), në nivel qendror dhe komunal; dhe
- Të mbrojë të drejtat e komuniteteve pakicë, në pajtueshmëri të plotë me standardet e të drejtave të njeriut.

Mandati i misionit të OSBE-së buron nga rezoluta e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, dhe Vendimi 305 i Këshillit të Përhershëm të OSBE-së, e cila vë Kosovën nën administrim të OKB-së. Edhe pse statusi i Kosovës pret të zgjidhet në të ardhmen dhe në ndërkohë nevojitet një rezolutë e re e OKB-së për Kosovën, Misioni do të operojë gjatë vitit 2007 me mandatin e tanishëm.

Fushat në të cilat momentalisht është i angazhuar Misioni përfshijnë përmirësimin e praktikave qeverisëse komunale që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mirë, me theks të veçantë në të drejtat e pakicave, qasjen në shërbimet e qeverisë, gjykata dhe polici, mjetet juridike dhe të drejtat e pronës, si dhe në mekanizmat publik këshillues dhe mbështetjen e mediave në gjuhët e komuniteteve pakicë.

Në nivel qendror, OSBE-ja ndihmon institucionet e përkohshme, në veçanti Kuvendin e Kosovës, Zyrën e Kryeministrit dhe Ministrinë në përbushjen e standardeve që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe qeverisjen e mirë. Përveç kësaj, Misioni është duke ndihmuar në modernizimin e institucioneve të arsimit të lartë dhe duke mbështetur punën e institucionit të Ombudspersonit, Institutit Juridik të Kosovës dhe rregullatorëve të medieve.

Në sektorin e sigurisë publike, Misioni është duke mbështetur themelimin e institucioneve të qëndrueshme arsimore të cilat do të ofrojnë shërbimet e veta dhe do të përmirësojnë tutje shërbimin policor, shërbimin e zjarrëfikseve dhe shpëtimit, si dhe shërbimin korrektues e atë doganor.

Mandati i OSBE-së nuk përban përgjegjësi ekzekutive, përveç të drejtave të rezervuara në procesin zgjedhor. Në të gjitha sferat tjera, OSBE bën monitorimin e përhershëm të situatës, identifikon dhe vlerëson të metat, raporton për to dhe rekomandon veprime konkrete. Aty ku është e nevojshme, OSBE ndihmon ngritjen e kapaciteteve profesionale të institucioneve vendore.

Struktura e misionit

Misioni OSBE-së përbush mandatin e vet përmes tri departamenteve programore:

- Departamenti për të drejta të njeriut, decentralizim dhe komunitete;
- Departamenti për qeverisje të mirë dhe institucione demokratike; dhe
- Departamenti për mbrojtje dhe siguri publike

Në nivel lokal, OSBE-ja realizon aktivitetet e veta me anë të një rrjeti të gjërë prej pesë (5) qendrash rajonale, dy (2) zyreve satelitore dhe 34 ekipeve komunale.

Ambasadori Werner Wnendt, diplomat gjerman është shef i Misionit që nga 28 prilli i vitit 2005.

PROGRAMET E MISIONIT

Programet e misionit të OSBE-së realizohen përmes tri departamenteve tematike, të cilat janë të strukturuar ashtu që të mund të arrijnë rezultatet më të mira të mundshme. Stafii i punësuar është me përvojë dhe me njohuri të veçanta në fusha të ndryshme të punës. Qendrat rajonale dhe ekipet komunale bëjnë bartjen e programeve të Misionit në terren.



Misioni OSBE-së ndihmon ekipin negociator të Kosovës në bisedimet teknike për statusin e ardhshëm të Kosovës

Të drejtat e njeriut, decentralizimi dhe komunitetet

Në shumicën e kuvendeve komunale të Kosovës ende ka shkelje të të drejtave të njeriut qoftë në ofrimin të shërbimeve apo gjatë zbatimit të ligjit. Theks i veçantë duhet t'i kushtohet mekanizmave për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe përgjegjësisë publike për të siguruar se institucionet komunale i përgjigjen kërkesave të të gjithë qytetarëve të saj.

Qëllim kryesor i programit për të drejta të njeriut, decentralizim dhe komunitete është të sigurojë se organet komunale; ekzekutivi, legjislativi dhe gjyqësori, veprojnë në bazë të standardeve për të drejta të njeriut, si dhe të vëzhgojë parimet e qeverisjes së mirë, në veçanti kur është fjala për komunitetet pakicë.

Për këtë arsye OSBE monitoron punën e 30 kuvendeve komunale dhe tri pilot-njësive komunale, gjykatave lokale si dhe organeve të zbatimit të ligjit.

Qeverisja komunale

Në nivel ekzekutiv, Ekipet Komunale (EK) të Misionit monitorojnë për së afërmi punën e zyrtarëve komunal për të parë nëse veprimet e tyre janë në pajtueshmëri me ligjin e aplikueshëm, dhe japin këshilla kryesisht për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut dhe të drejtën e qasjes në shërbime qeveritare, si shëndetësi dhe arsim, qasjen në dokumentacion zyrtar, çertifikatat dhe licencat, përdorimin e gjuhëve zyrtare dhe pagesat për anëtarësi dhe taksa. Gjithashtu, EK-të bëjnë monitorimin e ndarjes së barabartë të buxhetit për mbështetjen e komuniteteve pakicë.

Informatat, raportet dhe rekomandimet e punës së tyre shkëmbehen në vazhdimësi me zyrtarë në nivel komunal dhe qendror, për të siguruar një përcjellje të duhur institucionale dhe marrjen e masave të duhura, si dhe për t'u bërë me dije kuvendeve komunale për gabime të rastit që mund të bëhen si rezultat i vendimeve të marra në nivel qendror.

Sa i përket legjislativitetit komunal, EK-të bëjnë monitorimin e punës së kuvendeve komunale për të siguruar efikasitet të përgjithshëm, respektim të procedurave legjislative në mënyrë që ato të jenë në pajtim të plotë me të drejtat e njeriut si dhe mënyrën e zbatimit të ligjit.

Në nivel ekzekutiv dhe atë legjislativ, OSBE-ja monitoron dhe përiqet të sigurojë një përfaqësim të duhur të pakicave në vendimarrje, por edhe të sigurojë një nivel të duhur të transparencës në punën e kuvendit komunal që do të përfshinte konsultimet publike dhe auditimet nga jashtë. Gjithashtu, Misioni i OSBE-së mbështet kuvendet komunale në planifikimin buxhetor dhe detyrimet raportuese, si dhe ndihmon në modernizimin dhe reformimin e qeverisjes komunale në Kosovë.

Sistemi drejtësisë dhe policia

OSBE-ja vë një theks të veçantë në të drejtën penale dhe civile, dhe zbatimin e saj në bazë të standardeve për të drejtat e njeriut. Gjithashtu monitoron punën e policisë dhe ofron këshilla dhe rekomandime të duhura për politika dhe procedura të veprimit.

Sistemi gjyqësor është përgjegjës për përmirësimin e të drejtave të njeriut, në veçanti për pakica, pasi që policia është shpesh niveli i parë për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Andaj zhvillimi i vazhdueshëm i tyre është primar për Misionin.

Misioni harton raporte gjithëpërfshirëse për sistemin gjyqësor dhe sektorin e policisë, duke ofruar udhëzime të cilat shpërndahen mes autoriteteve gjyqësore, policore dhe faktorëve tjerë relevant (si: ministritë, Institucioni i Ombudspersonit). Kjo ka për qëllim adresimin e lëshimeve të mundshme në aplikimin e ligjit ekzistues në pajtueshmëri me të drejtat e njeriut në mënyrë që të sillen ndryshime pozitive.

OSBE ka mbështetur themelimin e institucioneve si: Instituti Gjyqësor i Kosovës, Inspektoriat i Policisë së Kosovës dhe Qendra e Kosovës për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim. Ato do të mbështeten edhe më tutje në ngritjen profesionale të zyrtarëve të tyre pasi që janë në shërbim të qytetarëve.

E drejta e pronës dhe mbrojtja e viktimave

Një sferë tjetër e cila në veçanti ka të bëjë me pakicat, kthimin dhe integrimin e tyre në shoqërinë kosovare, si dhe zhvillimin ekonomik, është respektimi dhe zbatimi i të drejtës së pronës. Mbrojtja e tyre varet nga cilësia e legjislacionit dhe politikat legjislative, si dhe zbatimi i tyre nga institucionet e drejtësisë dhe ato qeveritare, përfshirë këtu policinë. OSBE-ja monitoron dhe këshillon autoritetet vendore në të dy nivelet - qendror dhe lokal - se si t'iu qasen sfidave me të cilat ende përballet Kosova, në veçanti me të drejtën e pronës.

Mbështetje e ngjashme u ofrohet autoriteteve vendore edhe në sferën e mbrojtjes së viktimave të trafikimit. Misioni i OSBE-së bashkëpunon me të gjithë partnerët vendorë si në nivel lokal ashtu dhe në atë qendror, dhe me partnerët në sektorin joqeveritar, në gjyqësor dhe polici, për zhvillimin e një sistemi më të mirë për identifikimin e viktimave, mbrojtjen dhe integrimin e tyre. Duke i adresuar çështjet që kanë të bëjnë me trafikimin e qenieve njerëzore, OSBE ndihmon edhe në luftimin e krimit të organizuar në Kosovë.

Me qëllim të mbrojtjes dhe promovimit sa më të mirë të të drejtave të njeriut, OSBE mbështet punën e Institucionit të Ombudspersonit dhe i ofron këshilla profesionale.

Qeverisja e mirë dhe institucionet demokratike

Institucionet demokratike të Kosovës janë të reja dhe kanë nevojë për zhvillim të mëtejshëm. Përvoja e tanishme parlamentare është vetëm gjashtë vite e gjatë, dhe një numër i ministrive janë themeluar në vitin 2006. Problemet që paraqiten karshi institucioneve në nivel qendror janë nga më të ndryshmet, duke filluar nga ato procedurale deri tek ato buxhetore, përfshirë këtu kompetencat jo mirë të definuara dhe zhvillimin e pamjaftueshëm të mekanizmave mbikqyrës. Këto probleme shpesh shpiejnë në shkeljen e të drejtave të njeriut dhe në shërbime të pamjaftueshme publike.

Njëra ndër qëllimet afatgjata të Misionit ka qenë zhvillimi demokratik i institucioneve të Kosovës në nivel qendror. Në vitin 2007, programi për qeverisje të mirë dhe institucione demokratike fokusohet në Kuvendin e Kosovës dhe Zyrën e Kryeministrit me Ministri, në partitë politike dhe Komisionin Qendror Zgjedhor dhe Sekretariatit e tij.

OSBE është duke mbështetur edhe reformimin e institucioneve publike të arsimit të lartë dhe qasjen e komuniteteve pakicë në këto institucione. Po kështu, Misioni ofron asistencë në mësimin plotësues për të ndihmuar procesin e integritit të fëmijëve romë, ashkali dhe egjiptas në shkollat fillore dhe të mesme.

Për më tepër, OSBE mbështet punën e organeve vet-rregulluese të medieve si dhe transmetimin shumë-etnik dhe atë në gjuhët e pakicave në mbarë Kosovën.

Kuvendi dhe partitë politike

Mbështetja e vazhdueshme e Misionit ka qenë e orientuar në Kuvendin e Kosovës, organin më të lartë ligjvënës dhe mbikqyrës në IPVQ. Për ta ndihmuar zhvillimin e mëtejshëm të tij, OSBE-ja vazhdon ta monitorojë punën e Kuvendit të Kosovës edhe gjatë vitit 2007 dhe i ofron mbështetje në sferën e harmonizimit të procedurave dhe të mbikqyrjes së punës së Qeverisë, sidomos në periudhën e miratimit të buxhetit në veçanti për sektorin e sigurisë.

OSBE gjithashtu bashkëpunon ngushtë me Kuvendin e Kosovës për të përmirësuar procesin legjislativ, duke përfshirë miratimin e legjis-

lacionit plotësues, si dhe për të siguruar përfshirjen e komunitetit pakicë në këtë proces.

Kujdes i veçantë tregohet që puna e Kuvendit të Kosovës të bëhet e njohur për të gjithë qytetarët, përfshirë edhe ata të komuniteteve pakicë. Misioni do ta mbështesë iniciativën "Java e Kuvendit", që parashihet të zgjasë gjatë gjithë vitit 2007, e ku parashihet të ketë takime me qytetarë, takime me kuvendet komunale dhe hapje të zyrave të Kuvendit për zonat elektorale në disa komuna.

Misioni vazhdon ta mbështesë dialogun në mes të partive politike serbe dhe anëtarëve të Kuvendit si dhe rolin e tyre në Kuvend. Gjithashtu, OSBE bashkëpunon me partitë politike të spektrit shumicë, por edhe të komuniteteve pakicë, me qëllim që të përmirësojë funksionimin demokratik të tyre dhe aftësitë për të përfaqësuar interesat e votuesve.

Qeverisja e mirë

Në lëminë e ekzekutivit, Misioni mbështet punën e 15 ministrive ekzistuese duke i ndihmuar në themelimin e njësisve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut. Këto njësi kanë marrë detyrën nga Kryeministri që të sigurojnë se ministrinë veprojnë në pajtim me standardet për të drejta të njeriut dhe në bazë të ligjit të aplikueshëm, në veçanti në pajtim me ligjin e anti-diskriminimit dhe barazisë gjinore.

Veç kësaj, OSBE i ofron këshilla Zyrës së Kryeministrit për çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat e njeriut, me zbatimin e ligjit anti-diskriminim, si dhe mbështet punën e agjencionit kundër korrupsionit.

Zgjedhjet

Edhe pse zgjedhjet mbeten njëra nga përgjegjësitë e rezervuara të administratës së përkohshme të OKB-së, që i është besuar OSBE-së, kalimi i kësaj përgjegjësie tek autoritetet vendore është në fazën kritike. Pjesa më e madhe e përgjegjësisë operative të zgjedhjeve janë transferuar me sukses tek Komisioni Qendror Zgjedhor (KQZ) dhe Sekretariati i tij që në vitin 2004 dhe përgjegjësitë e mbetura duhet të transferohen tek këto organe me mbarimin e 120-ditëve të procesit të transferimit që parashihet të ndodh pas zgjidhjes së statusit të Kosovës.

Këto përgjegjësi përfshijnë mbajtjen e regjistrit të votuesve, regjistrimin e partive politike dhe raportimi i financave të tyre, menaxhimi i qendrës për numrim dhe rezultate si dhe votimi jashtë Kosovës. Pas transferimit të këtyre përgjegjësisë, Misioni pritet ta mbështesë KQZ-në dhe t'i ofrojë trajnime për operacionet e parapara pas zgjidhjes së statusit.



Me ndihmën e ofruar në zgjedhjet e studentëve në vitin 2006 OSBE-ja ka ndihmuar në depolitizimin e arsimit të lartë

Mbrojtja dhe siguria publike

Ende ekzistojnë boshllëqe në sektorin e sigurisë në Kosovë të cilat paraqesin një pengesë për zhvillim demokratik. Krimi i organizuar, korrupsioni dhe dhuna ndëretnike duhet të adresohet nga institucionet e sigurisë me një përpjekje të përbashkët të strukturave qeveritare dhe shoqërore.

Prioritetet e programit të ri të Misionit për mbrojtje dhe siguri publike përfshijnë zhvillimin e qëndrueshëm të institucioneve profesionale në këtë sektor dhe zhvillimin e strategjive të IPVQ-ve që do të krijojnë një ambient të sigurtë dhe përkushtim publik. Vëmendje e veçantë i kushtohet pjesëmarrjes së komuniteteve pakicë në strukturat ekzistuese të sigurisë, si dhe në perceptimin e sigurisë.

Zhvillimi institucional dhe trajnimet

OSBE-ja në mënyrë të vazhdueshme monitoron punën e të gjitha institucioneve për mbrojtje dhe siguri publike, përfshirë Shërbimin Policor të Kosovës, Departamentin për Menaxhim të Emergjencës (shërbimet e zjarrfikësve, shpëtimit, dhe mjeksore), shërbimet korrektuese dhe doganore, dhe ndihmon zhvillimin e tyre në mënyrë të drejtpërdrejt ose duke përkrahur punën dhe zhvillimin e qëndrueshëm të Qendrës Kosovare për Siguri Publike, Edukim dhe Zhvillim.

Për më tepër, Misioni ende ofron trajnime në nivelet e avancuara të shërbimit policor për luftimin e krimit të organizuar, hulumtimin e krimit si dhe në adresimin e dhunës në baza etnike dhe shkeljen e të drejtave të njeriut. Trajnime shtesë ofrohen për personelin e IPVQ-së në pozita udhëheqëse, në veçanti në institucionet për mbrojtje dhe siguri publike.

Mbështetje për zhvillim institucional i ofrohet ministrive të posaçësuara, Ministrisë për Punë të Brendshme dhe Inspektoriatit të

Policisë, të cilat janë në gjendje kritike të zhvillimit dhe rritjes së përgjegjësisë së brendshme, si dhe mbështetjes së të drejtave të njeriut në sektorin e sigurisë.

Forcimi i sektorit të sigurisë

OSBE-ja vazhdimisht merr pjesë në takimet për rishikimin e sektorit të sigurisë së brendshme, i cili i paraprinë bashkëpunimit në mes të të gjitha institucioneve që merren me çështjet e sigurisë si dhe ndihmon në hartimin e një plani gjithëpërfshirës për zhvillimin e sektorit të sigurisë. Misioni kontribuon në këtë proces me anë të inkuorpmimit të dimensionit njerëzor dhe aspektit më tradicional të sigurisë në Plan, si dhe duke ndihmuar në avansimin e mekanizmit mbrojtës për komunitetet pakicë.

Në lidhje me këtë, OSBE-ja-ja ndihmon në ngritjen e vetëdijes dhe mbështet punën e këshillave komunal për siguri të komuniteteve dhe komisioneve lokale për siguri publike, të cilat janë të hartuara për ta ndihmuar bashkëveprimin në mes mbrojtjes dhe institucioneve të sigurisë publike dhe popullatës lokale, në veçanti të komuniteteve pakicë.

Fakte dhe shifra

Programet e Misionit realizohen me përpjekjen e përbashkët të të gjithë anëtarëve të misionit. Për vitin 2007 Misioni ka gjithsej 999 të punësuar, prej të cilëve 716 janë vendorë dhe 283 ndërkombëtarë.

Buxheti i Misionit për këtë vit është 31,805,100 Euro. I gjithë ky fond është i orientuar drejt implementimit me sukses të mandatit dhe mbulimit të stafit përfshirë edhe të gjitha shpenzimet operative. Kontribues në buxhetin e Misionit janë 56 shtetet anëtare të OSBE-së.

Zyret e OSBE-së në teren

MITROVICË/MITROVICA

Leposavić/Leposaviq
Skenderaj/Srbica
Vushtrri/Vučitrn
Zvečan/Zvečan
Zubin Potok/Zubin Potok

PEJË/PEĆ

Deçan/Dečani
Klinë/Klina
Istog/Istok
PMU Junik/Junik

PRIZREN/PRIZREN

Dragash/Dragaš
Gjakovë/Đjakovica
Malishevë/Mališevo
Rahovec/Orahovac
Suharekë/Suva Reka
PMU Mamuşa/Mamushë/Mamuša

PRISHTINË/PRIŠTINA

Fushë Kosovë/Kosovo Polje
Glogovc/Glogovac
Lipjan/Lipljane
Obiliq/Obilić
Podujevë/Podujevo

GJILAN/GNJILANE

Ferizaj/Uroševac
Kaçanik/Kaçanik
Kamenicë/Kamenica
Novobërdë/Novo Brdo
Shtimë/Štimlje
Štrpce/Shtërpçë
Viti/Vitina
PMU Hani i Elezit/Đeneral Janković

Legjenda:

- Vija kufitare ndërkomunale
- Vija kufitare e zyreve rajonale të OSBE-së

GJILAN/GNJILANE – Zyra rajonale e OSBE-së dhe Ekipi Komunal
Deçan/Dečani – Ekipi Komunal i OSBE-së
PMU – Pilot Njësia Komunale